

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
PROJEKTI TIK/SMIL

**KRITERET PËR SHPËRNDARJEN E LËNDËVE NË
GJYKATAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËRMES
SISTEMIT TË MENAXHIMIT INFORMATIV TË LËNDËVE
(SMIL) DHE MËNYRA E ZBATIMIT TË TYRE**

Versioni: 2

Klasifikimi: Përdorim i brendshëm

Referenca: KGJK. Nr. ___/ 2024

Historiku i rishikimit te dokumentit

Versioni	Referenca	Data aprovimit	Përshkrimi i rishikimit
1	03/ 2020	29 Janar 2020	Versioni i parë i aprovuar në KGJK.
1.1	428/2021	29 Dhjetor 2021	Plotësuar: caktimi automatik për lëndët me dhunë në familje, përmbarimore jo kontestimore, masat e përkohshme, caktimi automatik i anëtarëve të paneleve, ri-caktimi i lëndëve (pika: 4 deri 8).
2	___/ __	___ Janar 2024	Plotësuar me kriteret për Gjykatën Komerciale

Janar, 2024

Përmbajtja:

Qëllimi	3
SHPËRNDARJA E LËNDËVE PËRMES SMIL	3
I. SHPËRNDARJA AUTOMATIKE	4
1. Struktura organizative	4
2. Kriteri i përjashtimit	4
2.1 Mënyra e funksionimit të këtij kriteri në gjykatën themelore	4
2.2 Mënyra e funksionimit të këtij kriteri në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme	5
3. Caktimi i gjyqtarit në mënyrë automatike	5
4. Caktimi i gjyqtarit në mënyrë automatike për lëndët me natyrë të veçantë për gjykatat themelore	7
5. Ri-caktimi i lëndëve	11
6. Përjashtimi i gjyqtarit nga lënda	14
7. Caktimi i Anëtarëve të Panelit në mënyrë automatike përmes SMIL-it në Gjykatat Themelore	14
8. Caktimi i gjyqtarëve dhe anëtarëve të kolegeve në Gjykatën Komerciale	20
II. SHPËRNDARJA MANUALE	22
III. Tabela: Zbatimi i planit të shpërndarjes së lëndëve	22

Qëllimi

Me vënien në zbatim të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL) në gjykata, krijohen kushtet për përmirësimin e procesit të punës në gjykata, gjë që ndikon në rritjen e efikasitetit në punë dhe në rritjen e transparencës në faza të ndryshme të procedimit të lëndëve. Proces kyç në këtë drejtim është shpërndarja e lëndëve në mënyrë automatike përmes SMIL-it.

Me këtë dokument përcaktohen kushtet dhe kriteret të cilat duhet të zbatohen nga gjykatat me rastin e shpërndarjes automatike të lëndëve përmes SMIL-it.

Kriteret e paraqitura në këtë dokument janë bazë për zhvillimin e funksionit të SMIL-it për shpërndarjen automatike të lëndëve në gjykata për të gjitha lëmit e në tre instancat gjyqësore: Gjykatat Themelore, Gjykatën e Apelit, Gjykatën Komerciale dhe për Gjykatën Supreme.

Parimet bazë të cilat janë marrë në konsideratë gjatë përcaktimit të kriterëve për shpërndarjen e lëndëve përmes SMIL janë:

- Shpërndarja e lëndëve dhe ngarkesa me numër të lëndëve të bëhet në bazë të kriterëve të njëjta dhe të barabarta për të gjithë gjyqtarët.
- Gjatë fazës së parë të regjistrimit të lëndës në gjykatë, dhe pa vonesa, të caktohet gjyqtari i lëndës nga SMIL në mënyrë automatike.
- Gjatë regjistrimit të lëndës në SMIL, të jetë e pamundur të parashikohet nga ana e përdoruesit të SMIL, se cilin gjyqtar do e caktoj sistemi.
- Të ketë transparencë të lartë në procesin e shpërndarjes së lëndëve në gjykata, duke eliminuar ndërhyrjen e njeriut në procesin e shpërndarjes së lëndëve.
- Të mundësojë nivel të lartë të monitorimit dhe raportimit të procesit të shpërndarjes së lëndëve.

SHPËRNDARJA E LËNDËVE PËRMES SMIL

Varësisht nga kushtet dhe mundësitë praktike në gjykata, shpërndarja e lëndëve përmes SMIL-it tek gjyqtarët, bëhet në dy mënyra:

1. Automatike dhe
2. Manuale

Në vazhdim në dokument janë paraqitur në mënyrë të detajuar dy mënyrat e shpërndarjes së lëndëve për rastet apo situatat në të cilat duhet të zbatohen, kriteret si dhe veprimet që duhet të

ndërmerren. Me këtë rast SMIL siguron zbatimin e plotë të dy metodave, duke siguruar, evidentuar dhe raportuar çdo veprim të ndërmarrë.

I. SHPËRNDARJA AUTOMATIKE

Sistemi në mënyrë autonome cakton gjyqtarin duke u bazuar në kriteret e përmendura më poshtë:

- Strukturën organizative
- Kriteret e përjashtimit dhe
- Caktimin në mënyrë automatike

1. Struktura organizative

Sistemi në algoritëm, si gjyqtarë potencial të cilëve do t'iu ndahet lënda, i përfshinë gjyqtarët e departamentit apo divizionit të cilit i përket lënda, në mënyrë që lënda t'i caktohet gjyqtarit/ve të departamentit apo divizionit përkatës.

Nëse në departament apo divizion është i angazhuar vetëm një gjyqtar, atëherë lënda automatikisht i caktohet atij gjyqtari.

Nëse një departament apo divizion, ka zero (0) gjyqtarë, atëherë gjatë regjistrimit të lëndës SMIL-i, në mënyrë automatike krijon një detyrë për kryetarin e gjykatës për të caktuar gjyqtarin. Kryetari i gjykatës, në kuadër të afateve të parapara me ligj, merr veprimet në SMIL për caktimin e gjyqtarit nga lista e gjyqtarëve në dispozicion.

2. Kriteri i përjashtimit

2.1 Mënyra e funksionimit të këtij kriteri në gjykatën themelore

Në Gjykatat Themelore, SMIL-i përjashton nga lista e gjyqtarëve potencial për të iu ndarë lënda për shqyrtim gjyqësor të çështjes, gjyqtarin i cili ka qenë i angazhuar në të njëjtin rast në procedurën paraprake. Përjashtimi nga ky rregull bëhet në lëndët penale për të mitur kur gjyqtari i procedurës paraprake duhet të jetë i njëjti edhe në shqyrtimin gjyqësor.

Sistemi përjashton nga lista e kandidatëve potencial, gjyqtarët të cilët gjenden në pushim më gjatë se 30 ditë për arsye të ndryshme (sëmundje, trajnime, studime...), të cilëve nuk iu ndan lëndë të reja në punë, si dhe gjyqtarin e përjashtuar më herët nga lënda.

Sistemi përjashton nga algoritmi kryetarët e gjykatave themelore. Kryetarët, sipas vlerësimit të nevojave të gjykatës me të cilën menaxhojnë, mund të angazhohen në gjykimin e çështjeve të ndryshme gjyqësore.

2.2 Mënyra e funksionimit të këtij kriteri në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme

Me rastin e caktimit të kolegjit gjykues në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, sistemi përjashton nga lista e kandidatëve potencial, gjyqtarët të cilët gjenden në pushim më gjatë se 30 ditë, për arsytet e njëjta si në Gjykatat Themelore, si dhe gjyqtarin e përjashtuar më herët nga lënda.

Sistemi, po ashtu, përjashton nga lista e gjyqtarëve potencial për t'iu ndarë lënda, për shqyrtimin e ankesës së parashtruar ndaj vendimit lidhur me çështjen kryesore, gjyqtarin i cili në Gjykatën themelore apo në Gjykatën e Apelit, si në cilësi të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues, anëtarit të trupit gjykues, apo anëtarit apo kryetarit të kolegjit gjykues, ka marrë pjesë në marrjen e vendimit me të cilin në atë rast është caktuar - vazhduar ndonjë masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit (*cilëndo masë të paraparë me Nenin 173.1 të Kodit të procedurës penale 04/L-123*).

Sistemi përjashton nga lista e gjyqtarëve potencial për të ju caktuar lënda si anëtar i kolegjit (*kryetar i kolegjit, gjyqtar raportues apo anëtar*), edhe gjyqtarin i cili në çështjen e njëjtë në gjykatën më të ulët ose në gjykatën e njëjtë, ka marrë pjesë në marrjen e vendimit i cili atakohet me mjet juridik.

Sistemi përjashton nga lista e kandidatëve potencial gjyqtarin e praktikës gjyqësore në muajin kur nuk duhet të pranoj lëndë të reja.

Sistemi përjashton nga algoritmi kryetarit e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Kryetarët, sipas vlerësimit të nevojave të gjykatës me të cilën menaxhojnë, mund të angazhohen në gjykimin e çështjeve të ndryshme gjyqësore.

3. Caktimi i gjyqtarit në mënyrë automatike

Pasi të jenë e regjistruara të dhënat e duhura për lëndën dhe pas zbatimit të kriterëve të lartcekura të përjashtimit, SMIL-i në mënyrë automatike do të caktojë gjyqtarin e lëndës nga lista e gjyqtarëve në dispozicion.

SMIL-i, në vijim, cakton gjyqtarin e lëndës, në këtë mënyrë:

- menjëherë, në momentin e pranimin të lëndës
- në mënyrë plotësisht të rastësishme
- varësisht nga ngarkesa e gjyqtarëve me numër të lëndëve në kuadër të dep./div. përkatës
- gjyqtarët ngarkohen me numër të balancuar të lëndëve në kuadër të dep./div. përkatës

Balancim nënkupton ngarkesën e gjyqtarëve me lëndë me numër përafërsisht të njëjtë gjatë tërë kohës, dhe se ndryshimi në mes të ngarkesës së tyre me lëndë, asnjëherë nuk do ta kalon numrin e caktuar maksimal të lëndëve, të përcaktuar më poshtë në tekstin e këtij dokumenti.

Për zbatimin e shpërndarjes së balancuar të lëndëve të gjyqtarët, SMIL-i merr parasysh numrin e gjyqtarëve në dispozicion në departamentin apo divizionin përkatës për t'iu ndarë lënda, ngarkesën me lëndë të gjyqtarëve, e cila mund të rezultojë e ndryshueshme, por që balancohet me kohën dhe asnjëherë nuk do ta kalojë numrin e caktuar të lëndëve, si më poshtë:

- për 2 gjyqtar, diferenca jo më e madhe se 5 lëndë
- për 3 gjyqtar, diferenca jo më e madhe se 4 lëndë
- për 4 gjyqtar, diferenca jo më e madhe se 3 lëndë
- për 5 apo më shumë gjyqtar, diferenca jo më e madhe se 2 lëndë
- gjyqtarët e rinj ngarkohen me një të tretën (1/3) e lëndëve në krahasim me gjyqtarët e tjerë.
- gjyqtarët anëtarë të KGJK ngarkohen me dy të tretat (2/3) e lëndëve në krahasim me gjyqtarët e tjerë.

Shembull: Në rastin më të thjeshtë që ka të bëjë me 2 gjyqtar brenda një dep./div., çdo lëndë të re që do të caktohet, gjasat janë 50% me 50% për të dy gjyqtarët që t'iu caktohet lënda. Kjo siguron ngarkesën e balancuar me lëndë për gjyqtarët të cilën e zbaton vet SMIL-i.

Kjo metodë eviton mundësinë e parashikimit nga ana e regjistruarit se cilit gjyqtarë do ti caktohet në punë lënda e cila është në proces të regjistrimit.

Caktimi i rastësishëm i gjyqtarit nga sistemi, procesi (Zgjidhja teknike në SMIL)

Për të sqaruar pjesën teknike të hapave që zbatohen në SMIL për të caktuar gjyqtarin në mënyrë plotësisht automatike, sqarimi do të bëhet përmes një shembulli.

Le të supozojmë se referenti në gjykatë (përdoruesi i SMIL) është duke regjistruar në SMIL një lëndë të re penale në departamentin e përgjithshëm që ka 9 gjyqtar. Me këtë rast hapat që zbatohen nga SMIL për caktimin e gjyqtarit janë:

Hapi i parë, zbatimi i kriterit të përjashtimit; në bazë të kriterëve të përcaktuara për përjashtimin e gjyqtarëve të cekura më lart, SMIL përjashton nga lista e gjyqtarëve potencial për të ju ndarë lënda të gjithë gjyqtarët e mundshëm. Me këtë rast supozojmë se SMIL ka përjashtuar një (1) gjyqtar që ka pasur rastin e njëjtë gjatë procedurës paraprake.

Hapi i dytë, caktohet lista e gjyqtarëve potencial që mund të ju caktohet lënda; pasi SMIL ka larguar nga lista gjyqtarët të cilët duhet të përjashtohen, për rastin konkret, SMIL ka në listë 8 gjyqtar, njërit nga të cilit SMIL në mënyrë të rastësishme do ja caktoj lëndën.

Hapi i tretë; SMIL cakton Globally Unique Identifier (GUID) për secilin gjyqtar në listë. Në tabelën e paraqitur në vazhdim, janë paraqitur emrat e 8 gjyqtarëve, dhe shifrat e tyre të përcaktuara (GUID) nga SMIL.

Të dhënat e paraqitura në tabelë janë:

- ID – është numri identifikues i pandryshueshëm në SMIL për gjyqtarin,
- Gjyqtari – është emri i gjyqtarit,
- (GUID) – është shifra GUID e gjeneruar nga SMIL vetëm për këtë rast të shpërndarjes së lëndës. Këtë shifër, SMIL e gjeneron nga koha momentale e sistemit (run-time). Për secilin gjyqtar në listë, SMIL merr kohën momentale të sistemit kompjuterik, këtë kohë e konverton në numër hexadecimal si në tabelë dhe ja atribuon gjyqtarit.

ID	Gjykatësi	(GUID)
250	Irfan	D64F14E5-B674-49C3-AB24-0325B30B046B
255	Valon	EF5ED4A6-7FFA-438E-B72B-209636526CF5
251	Albatrit	782FB47F-FEB1-4E31-AD23-32E9BCD3C4F3
249	Valmir	6A96010C-0BD8-4826-9C86-6ED8E060DDD9
254	Albatrit	8CB36BD5-F8FB-408D-AA3D-71E947B75466
256	Mergim	AA0592A9-D5F7-42A4-9DF2-A21C67418F08
252	Valon	95D8F756-4B13-41E5-BBB3-B6FBF8367DE4
253	Perparim	19128AA2-FEDC-4AC0-B5EA-FEABDB4FA266

Hapi i katërt, caktimi i gjyqtarit; Pasi SMIL ti ketë caktuar (GUID) për secilin gjyqtar (kolona e fundit), lëndën ja cakton gjyqtarit sipas renditjes së karaktereve më i vogli (0,1,2,3,4,5,6,7,8,9,A,B,C,D,E,F) nga e djathta (GUID). Në këtë rast lënda do i caktohej gjyqtarit Perparim me ID 253.

(GUID) caktohet nga SMIL për secilin gjyqtar, për secilën lëndë që do të shpërndahet dhe është unike, si dhe përdoret vetëm për at rast, duke siguruar rastësi të plotë në caktimin e emrit të gjyqtarit.

4. Caktimi i gjyqtarit në mënyrë automatike për lëndët me natyrë të veçantë për gjykatat themelore

Për lëndët me natyrë të veçantë, SMIL-i bënë caktimin e gjyqtarit në mënyrë automatike te gjyqtarët e veçantë që merren me këto lëndë. Në gjykatë janë disa kategori të lëndëve me natyrë të veçantë, për të cilat do të bëhet shpërndarja e lëndëve te gjyqtarët e caktuar. Në kuadër të lëndëve me natyrë të veçantë hyjnë lëndët që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe lëndët përmbartimore, andaj edhe caktimi i gjyqtarit në mënyrë automatike, bëhet për këto kategori:

- Shpërndarja e lëndëve (caktimi i gjyqtarit) në mënyrë automatike për lëndët penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje,
- Shpërndarja e lëndëve (caktimi i gjyqtarit) në mënyrë automatike për raste e dhunës në familje si çështje civile.
- Shpërndarja automatike e lëndëve përmbartimore.
- Shpërndarja automatike e lëndëve jo kontestimore.
- Shpërndarja automatike e masave të përkohshme në lëmin civile

Shpërndarja e lëndëve në mënyrë automatike të gjyqtarët e caktuar zbatohet vetëm në Gjykatat Themelore. Në Degë Gjykatave Themelore, shpërndarja automatike e lëndëve me natyrë të veçantë për këto kategori nuk zbatohet.

4.1 Shpërndarjes automatike të lëndëve të gjyqtarët e caktuar për lëndët penale që kanë të bëjnë me dhunë në familje, do të realizohet ashtu që:

Për shpërndarjen e lëndëve për rastet penale që kanë të bëjnë me dhunë në familje, në SMIL do të krijohet një grup e gjyqtarëve me emrin ‘‘DVCriminal’’ (Domestic Violence Criminal). Në këtë grup, do të vendosen gjyqtarët të Departamentit të Përgjithshëm Penal që do të punojnë me rastet penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

Grupi DVCriminal do të krijohet ashtu që:

- a) Kryetari i gjykatës, përmes vendimit me shkrim vendosë se cilët gjyqtarë do të jenë anëtarë të grupit DVCriminal.
- b) Për të qenë anëtarë në grupin DVCriminal, ai/ ajo duhet të plotësojë të gjitha kriteret ligjore që kërkohen për të punuar si gjyqtar në DPP dhe të ketë trajnime të ndjekura për trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me dhunë në familje.

Nëse, në rastet e veçanta kur nuk ka asnjë gjyqtar në dispozicion në grupin e DVCriminal për të caktuar gjyqtarin në mënyrë automatike (kjo situatë e veçantë mund të paraqitet në praktikë në rrethana të ndryshme), SMIL duhet të ketë alternativë për caktimin e gjyqtarit, për të mundësuar vazhdimin e regjistrimit dhe zgjidhjes së lëndës. Për këtë qëllim, në departamentin që i përket lënda (Departamenti i Përgjithshëm Penal DPP), në SMIL krijohet një grup e gjyqtarëve me emrin DVCriminal Rezervë.

- Kryetari i gjykatës, përmes vendimit me shkrim vendosë se cilët do të jenë gjyqtarët rezervë që do të jenë në dispozicion për trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me dhunë në familje (në grupin Alternativ të DVCriminal Rezervë).
- Gjyqtarët nga ky grup alternativ të kenë ndjekur trajnimet për dhunë në familje në Akademi. Këta gjyqtarë do të angazhohen në këto lëndë, vetëm në mungesë të gjyqtarëve të rregullt që merren me lëndët e dhunës në familje.

Rastet e veçanta kur në grupin DVCriminal të gjyqtarëve, nuk ka gjyqtarë (që janë avancuar në detyrë ose transferuar) apo janë në pushim më gjatë se 30 ditë për arsye të ndryshme si: sëmundje, trajnime, studime.... sipas kriterëve të përjashtimit të cekura në pikë2 të cekur më lartë, SMIL nuk ndërprejnë regjistrimin e lëndës. Në këto raste, SMIL cakton një gjyqtar tjetër në mënyrë automatike nga grupi DVCriminal Rezervë që i përket DPP, i cili i ka ndjekur trajnimet për DV (dhunë në familje).

Shpërndarja e lëndëve në Departamentin Penal duhet të bëhen në mënyrë të njëjtë të të gjithë gjyqtarët që janë në këtë departament, pa marrë parasysh se janë apo nuk janë anëtarë në grupin DVCriminal dhe grupit DVCriminal Rezervë.

4.2 Shpërndarjes automatike e lëndëve të gjyqtarët e caktuar për lëndët që kanë të bëjnë me dhunë në familje, si çështje civile do të realizohet ashtu që:

Për shpërndarjen e lëndëve për rastet civile që kanë të bëjnë me dhunë në familje, në SMIL do të krijohet një grupë e gjyqtarëve me emrin "DVCivile" (Domestic Violence Civil). Në këtë grup, do të vendosen gjyqtarët e Departamentit Civil që do t'i trajtojnë rastet që kanë të bëjnë me dhunë në familje.

Grupi DVCivile do të krijohet si më poshtë:

- a) Kryetari i gjykatës, përmes vendimit me shkrim vendosë se cilët gjyqtarë do të jenë anëtarë të grupit DVCivil.
- b) Për të qenë gjyqtar në grupin DVCivil, ai/ajo duhet të plotësoj të gjitha kriteret ligjore që kërkohen për të punuar si gjyqtar në DC dhe të ketë trajnime të ndjekura për trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me dhunë në familje.

Nëse, në rastet e veçanta kur nuk ka asnjë gjyqtar në dispozicion në grupin e DVCivile për të caktuar gjyqtarin në mënyrë automatike (kjo situatë e veçantë mund të paraqitet në praktikë në rrethana të ndryshme), SMIL duhet të ketë alternativë për caktimin e gjyqtarit, për të mundësuar vazhdimin e regjistrimit dhe zgjidhjes së lëndës. Për këtë qëllim, në departamentin që i përket lënda (Departamenti Civil DC), në SMIL krijohet një grupë e gjyqtarëve me emrin DVCivile Rezervë.

- Kryetari i gjykatës, përmes vendimit me shkrim vendosë se cilët do jenë gjyqtarët rezervë që do të jenë në dispozicion për trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me dhunë në familje si çështje civile (në grupin DVCivil Rezervë).
- Për të qenë gjyqtar në grupin DVCivil Rezervë, ai/ajo duhet të plotësoj të gjitha kriteret ligjore që kërkohen për të punuar si gjyqtar në DC dhe të ketë trajnime të ndjekura për trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me dhunë në familje.

Rastet e veçanta kur në grupin DVCivile të gjyqtarëve, nuk ka gjyqtarë (që janë avancuar në detyrë ose transferuar) apo janë në pushim më gjatë se 30 ditë për arsye të ndryshme si: sëmundje, trajnime, studime.... sipas kriterëve të përjashtimit të cekura në pikë2 të cekur më lartë, SMIL nuk ndërprejnë regjistrimin e lëndës. Në këto raste, SMIL cakton një gjyqtar tjetër në mënyrë automatike nga grupi DVCivil Rezervë që i përket DC, i cili i ka ndjekur trajnimet për DV (dhunë në familje).

Shpërndarja e lëndëve në Departamentin Civil duhet të bëhen në mënyrë të njëjtë të të gjithë gjyqtarët që janë në këtë departament, pa marrë parasysh se janë apo nuk janë anëtarë në grupin DVCivil dhe grupit DVCivil Rezervë.

Gjyqtarët që janë anëtarë të grupeve DVCriminal dhe DVCivile, do të marrin të gjitha lëndët që janë me natyrë të dhunës në familje. Këta gjyqtarë, do të marrin edhe lëndët tjera në departamentin civil derisa ngarkesa me lëndë e tyre të jetë e balancuar me gjyqtarët e tjerë në departament.

4.3 Shpërndarja automatike e lëndëve të gjyqtarët e caktuar për lëndët përbarimore, do të realizohet ashtu që:

Për shpërndarjen e lëndëve për rastet civile përbarimore, në SMIL do të krijohet një grup e gjyqtarëve me emrin ‘Përbarimore’. Në këtë grup, do të vendosen gjyqtarët të Departamentit të Civil që do të punojnë me lëndët përbarimore.

Grupi Përbarimore do të krijohet ashtu që:

- a) Kryetari i gjykatës, përmes vendimit me shkrim vendosë se cilët gjyqtarë do të jenë anëtarë të grupit Përbarimore.
- b) Për të qenë anëtarë në grupin Përbarimore, ai/ ajo duhet të plotësoj të gjitha kriteret ligjore që kërkohen për të punuar si gjyqtar në DC.

Nëse, në rastet e veçanta kur nuk ka asnjë gjyqtar në dispozicion në grupin e Përbarimore për të caktuar gjyqtarin në mënyrë automatike (kjo situatë e veçantë mund të paraqitet në praktikë në rrethana të ndryshme), SMIL duhet të ketë alternativë për caktimin e gjyqtarit, për të mundësuar vazhdimin e regjistrimit dhe zgjidhjes së lëndës. Për rastet kur ka mungesë të gjyqtarëve në grupin Përbarimore, atëherë SMIL-i cakton gjyqtarin e lëndës duke marrë gjyqtarë tjerë nga Departamenti Civil.

4.4 Shpërndarja automatike e lëndëve të gjyqtarët e caktuar për lëndët Jo kontestimore, do të realizohet ashtu që:

Për shpërndarjen e lëndëve për rastet civile Jokontestimore, në SMIL do të krijohet një grup e gjyqtarëve me emrin ‘Jo kontestimore’. Në këtë grup, do të vendosen gjyqtarët të Departamentit të Civil që do të punojnë me lëndët Jokontestimore.

Grupi Jo kontestimore do të krijohet ashtu që:

- a) Kryetari i gjykatës, përmes vendimit me shkrim vendosë se cilët gjyqtarë do të jenë anëtarë të grupit Jo kontestimore.
- b) Për të qenë anëtarë në grupin Jokontestimore, ai/ ajo duhet të plotësoj të gjitha kriteret ligjore që kërkohen për të punuar si gjyqtar në DC.

Nëse, në rastet e veçanta kur nuk ka asnjë gjyqtar në dispozicion në grupin Jokontestimore për të caktuar gjyqtarin në mënyrë automatike (kjo situatë e veçantë mund të paraqitet në praktikë në rrethana të ndryshme), SMIL duhet të ketë alternativë për caktimin e gjyqtarit, për të mundësuar vazhdimin e regjistrimit dhe zgjidhjes së lëndës. Për rastet kur ka mungesë të gjyqtarëve në grupin Jokontestimore, atëherë SMIL-i cakton gjyqtarin e lëndës duke marrë gjyqtarë tjerë nga Departamenti Civil.

4.5 Shpërndarja automatike e masave të përkohshme në lëmin civile, do të realizohet ashtu që:

Për shpërndarjen e masave të përkohshme për rastet civile/ administrative, në SMIL do të krijohet një grup e gjyqtarëve me emrin “**Masat**”. Në këtë grup, do të vendosen gjyqtarët të Departamentit të Civil që do të punojnë me masat e përkohshme.

Grupi **Masat** do të krijohet ashtu që:

- a) Kryetari i gjykatës, përmes vendimit me shkrim vendosë se cilët gjyqtarë do të jenë anëtarë të grupit **Masat**.
- b) Për të qenë anëtarë në grupin Masat, ai/ ajo duhet të plotësoj të gjitha kriteret ligjore që kërkohen për të punuar si gjyqtar në DC.

Nëse, në rastet e veçanta kur nuk ka asnjë gjyqtar në dispozicion në grupin Masat për të caktuar gjyqtarin në mënyrë automatike (kjo situatë e veçantë mund të paraqitet në praktikë në rrethana të ndryshme), SMIL duhet të ketë alternativë për caktimin e gjyqtarit, për të mundësuar vazhdimin e regjistrimit dhe zgjidhjes së lëndës. Për rastet kur ka mungesë të gjyqtarëve në grupin Masat, atëherë SMIL-i cakton gjyqtarin e lëndës duke marrë gjyqtarë tjerë nga Departamenti Civil/ Administrativ.

5. *Ri-caktimi i lëndëve*

Ri-caktimi i lëndëve të cilat më herët u janë caktuar gjyqtarëve, bëhet për rastet e caktuara si në vijim:

5.1 Kur gjyqtari largohet përfundimisht nga departamenti / divizioni ose gjykata (për shkak të ngritjes në detyrë, transferimit, dorëheqjes, pensionit, etj.):

a. Nëse gjyqtari që largohet përfundimisht nga departamenti / divizioni / gjykata do të **zëvendësohet nga një gjyqtar tjetër brenda 1 muaji** nga largimi i tij / saj (bazuar në një vendim të KGJK-së), të gjitha lëndët e tij / saj të pazgjidhura do t'i ri-caktohen këtij gjyqtari përmes SMIL.

b. Nëse gjyqtari që po largohet përfundimisht nga departamenti / divizioni / gjykata **nuk do të zëvendësohet brenda 1 muaji**, të gjitha lëndët e tij / saj të pazgjidhura do të ri-caktohen automatikisht gjyqtarëve të tjerë të të njëjtit departament / divizion. Ri-caktimi i këtyre lëndëve bëhet në grup. Kjo do të thotë se të gjitha lëndët e pa kryera të gjyqtarit, njëherësh do t'u transferohen gjyqtarëve të tjerë përmes algoritmit automatik të SMIL. Ri-caktimi i këtyre lëndëve bëhet me një vendim me shkrim të kryetarit të gjykatës, i cili duhet t'i bashkëngjitet SMIL.

5.2 Kur gjyqtari mungon në gjykatë për një pushim afatgjatë, përkatësisht, për më shumë se 6 muaj (pushim i gjatë sëmundjeje, pushim lindjes, studime / trajnime afatgjata, pezullim afatgjatë):

- a. Nëse gjyqtari që do të mungojë në gjykatë për më shumë se 6 muaj do të zëvendësohet nga një gjyqtar tjetër brenda 1 muaji nga fillimi i pushimit të tij / saj, **të gjitha lëndët e tij / saj të pazgjidhura do të ri-caktohen në këtë gjyqtar përmes SMIL;**
- b. Nëse gjyqtari që do të mungojë për më shumë se 6 muaj nuk do të zëvendësohet brenda 1 muaji, **të gjitha lëndët e tij / saj të pazgjidhura do të ri-caktohen** automatikisht dhe rastësisht midis gjyqtarëve të tjerë të të njëjtit departament / divizion. Ri-caktimi i këtyre lëndëve bëhet në grup. Kjo do të thotë se të gjitha lëndët e pa kryera të gjyqtarit, njëherësh do t'u transferohen gjyqtarëve të tjerë përmes algoritmit automatik të SMIL. Ri-caktimi i këtyre lëndëve bëhet me një vendim me shkrim të kryetarit të gjykatës, i cili duhet t'i bashkëngjitet SMIL.

5.3 Kur gjyqtari mungon në gjykatë për një pushim afatmesëm, përkatësisht, për më shumë se 1 muaj, por më pak se 6 muaj:

Vetëm lëndët urgjente të pazgjidhura do të ri-caktohen automatikisht dhe rastësisht midis gjyqtarëve të tjerë të të njëjtit departament / divizion.

Gjyqtari i cili shkon në pushim është i obliguar të njoftoj kryetarin me shkrim për lëndët që janë urgjente dhe të cilat duhet të procedohen më tutje gjatë periudhës sa do të mungojë. Kryetari i Gjykatës, para aprovimit të pushimit, bënë ri-caktimin e të gjitha lëndëve urgjente te gjyqtarët tjerë të të njëjtit departament / divizion. Ri-caktimi i këtyre lëndëve bëhet me një vendim me shkrim të Kryetarit të Gjykatës, i cili duhet t'i bashkëngjitet SMIL-it.

Seancat dëgjimore të planifikuara duhet të shtyhen domosdoshmërisht.

5.4 Balancimi i ngarkesës me lëndë në departament / divizion pas rekrutimit të gjyqtarëve të rinj, gjyqtarëve të transferuar në departament dhe gjyqtarëve që kthehen nga pushimi afate gjatë:

Për të bërë balancimin e ngarkesës me lëndë, mund të zbatohet metoda e paraqitur në vazhdim.

Me ardhjen e gjyqtarit të ri në dep/div, ai/ ajo duhet të ngarkohet me lëndë që janë në punë në dep/ div, në mënyrë të barabartë me gjyqtarët e tjerë. Lëndët të cilat duhet ti merren gjyqtarëve tjerë duhet të zgjedhën në mënyrë rastësore (me short). Nga shorti për ri caktim të lëndëve gjyqtarëve të rinj, në raste të veçanta duhet të largohen lëndët me të cilat gjyqtarët kanë marrë veprime dhe janë afër kryerjes.

5.5 Kur gjyqtari avancohen në detyrë. Rasti kur gjyqtari avancohet në detyrë nga gjykata themelore në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën Supreme. Në këto raste, në SMIL të gjitha lëndët e gjyqtarit duhet të ri-caktohen në mënyrë automatike menjëherë gjyqtarëve tjerë. Ri-caktimi i lëndëve duhet të bëhet menjëherë pasi në SMIL gjyqtari nuk mund të ketë profil aktiv në dy instanca gjyqësore dhe nuk mund të punoj në gjykatën e re derisa në gjykatën e mëparshme ende ka lëndë në profilin e tij.

5.6 Ri-caktimi i lëndëve në mënyrë manuale, kryetari i gjykatës në raste të veçanta bënë ri-caktimin e lëndëve në mënyrë manuale përmes SMIL-it te gjyqtari tjetër. Ri-caktimi manual duhet të zbatohet vetëm në raste të veçanta dhe për këtë **kryetari duhet të përgatis raport me arsyetimin e ri-caktimit të lëndës manualisht**. Ri-caktimi manual mund të zbatohet në rastet; për shembull nëse një gjyqtar është ende në trajnim si gjyqtar i ri (trajnim i detyrueshëm një vjeçar i organizuar nga Akademia e Drejtësisë) merr një lëndë, të cilën mentori e konsideron shumë komplekse për gjyqtarin në trajnim, atëherë gjyqtari në trajnim mund të pyesresidentin e Gjykatës për t'ia ri-caktuar lëndën një gjykatësi tjetër në departament / divizion. Kryetari i Gjykatës do të ri-caktojë lëndën manualisht te ndonjë gjyqtar tjetër.

Shënim:

Në rastin e ri-caktimit të lëndës manualisht, kryetari i gjykatës në vendimin për ri-caktimin e lëndës duhet të japë edhe arsyetimin pse ka bërë ri-caktimin e gjyqtarit të lëndës në mënyrë manuale dhe vendimin ta bashkëngjis në SMIL.

5.7 Për çdo ri-caktim tjetër të jashtëzakonshëm, lënda ri-caktohet automatikisht përmes SMIL-it te gjyqtari tjetër.

5.8 Përzgjedhja e lëndëve me të cilat kryetarët e gjykatave mund të angazhohen si gjyqtar të lëndës mund të bëhet në dy mënyra:

Nëse kryetarët e gjykatave planifikojnë të angazhohen në zgjidhjen e lëndëve, atëherë përzgjedhja e lëndëve duhet të bëhet përmes SMIL-it në mënyrë rastësore. Kjo duhet të realizohet ashtu që kryetari i gjykatës përfshihet në kuadër të shpërndarjes automatike të lëndëve për periudhë të caktuar në departamentin në të cilin dëshiron të angazhohet në zgjidhjen e lëndëve.

Hapat që duhet të zbatohen për ri-caktimin e lëndëve:

Hapi 1. Kryetari i gjykatës përgatit vendimin me shkrim për ri-caktimin e lëndës apo lëndëve për rastet e cekura në pikën 5.

Hapi 2. Kryetari i gjykatës mundet:

a. vet të bashkëngjit në SMIL vendimin e ri-caktimit të lëndëve dhe ekzekuton hapin e ri-caktimit të lëndëve.

b. të udhëzoj asistenten e vet të realizoj në SMIL ri-caktimin e lëndëve. Me këtë rast, asistentja e kryetarit të gjykatës ka të drejtë në SMIL ti kryej detyrat e kryetarit të gjykatës që kanë të bëjnë me ri-caktimin e lëndëve. Me këtë rast, asistentja e kryetarit të gjykatës duhet të bashkëngjit në SMIL vendimin me shkrim të kryetarit për ri-caktimin e lëndëve dhe ekzekuton detyrën e ri-caktimit.

Hapi 3. Me rastin e kryerjes së detyrës për ri-caktimin e lëndëve, SMIL-i krijon detyrë për shefin e shkrimores. Përmes detyrës, SMIL-i i dërgon vendimin e kryetarit shefit të shkrimores, i cili është përgjegjës për të siguruar se lëndët do të barten edhe fizikisht nga gjyqtari që janë marrë lëndët, te gjyqtari i ri i ri-caktuar.

6. Përrjashitimi i gjyqtarit nga lënda

Përrjashitimi i gjyqtarit nga lënda bëhet në rastet e përcaktura me ligj. Me këtë rast, për zgjedhjen e gjyqtarit të ri të lëndës, SMIL-i zbaton kushtet dhe kriteret e njëjta me të cilat është zgjedhur gjyqtari i përrjashtuar.

Hapat që duhet të zbatohen për përrjashitimin e gjyqtarit nga lënda:

Hapi 1. Gjyqtari, kërkesën për përrjashitim e bënë me shkrim dhe përrmes SMIL-it dërrgon te kryetari i gjykatës për aprovim.

Hapi 2. Kryetari i gjykatës përrgatit vendimin me shkrim për përrjashitimin e gjyqtarit nga lënda.

Hapi 3. Kryetari i gjykatës mundet:

a. vet të bashkëngjit në SMIL vendimin e përrjashtitimit të gjyqtarit nga lënda dhe ekzekuton hapin e përrjashtitimit të gjyqtarit nga lënda.

b. të udhëzoj asistenten e vet të realizoj në SMIL përrjashitimin e gjyqtarit nga lënda. Me këtë rast, asistentja e kryetarit të gjykatës ka të drejtë në SMIL ti realizoj detyrat e kryetarit të gjykatës që kanë të bëjnë me përrjashitimin e gjyqtarëve nga lënda. Me këtë rast, asistentja e kryetarit të gjykatës duhet të bashkëngjis në SMIL vendimin me shkrim të kryetarit për përrjashitimin e gjyqtarit nga lënda dhe të ekzekutoj detyrën në SMIL për përrjashitimin e gjyqtarit.

Hapi 4. Nëse kërkesa për përrjashitim është aprovuar, SMIL-i krijon një detyrë për shefin e shkrimores. Përrmes detyrës, SMIL-i i dërrgon vendimin e kryetarit shefit të shkrimores, i cili është përrgjegjës për të siguruar se lëndët do të barten edhe fizikisht nga gjyqtari i përrjashtuar nga lënda, te gjyqtari i ri i ri-caktuar

Për ri-caktimin dhe përrjashitimin e gjyqtarëve nga lënda, vlejné kriteret dhe hapat e njëjtë si për rastet kur gjyqtari është bartës i lëndës, ashtu për raste kur gjyqtari është anëtar paneli.

7. Caktimi i Anëtarëve të Panelit në mënyrë automatike përrmes SMIL-it në Gjykatat Themelore

Caktimi i anëtarëve të paneleve dhe trupave gjykuese bëhet në mënyrë automatike në SMIL duke marrë gjyqtarë nga departamenti që i përrket lënda. Për shembull, për lëndën që i përrket departamentit të Civil, anëtarët e penelit do të përrzgjidhen nga Departamenti Civil.

Në praktikë, mund të ndodhë që gjykata të ndodhet në rrethana të caktuara që nuk ka gjyqtarë të mjaftueshëm në departamentin që i përrket lënda për të krijuar panelin. Në situata të tilla, gjykata mund të ndodhet edhe për periudha të caktuara kohore dhe për këto raste SMIL-i duhet të ketë zgjidhje për caktimin e anëtarëve të paneleve.

Mënyra e caktimit të anëtarëve të paneleve për gjykatat themelore, duke mundësuar caktimin në mënyrë automatike të anëtarëve të panelit në rastet kur departamenti të cilit i përket lënda nuk ka gjyqtarë të mjaftueshëm në dispozicion, bëhet si në vijim:

- Zgjidhja do të jetë e njëjtë dhe do të aplikohet në të gjitha gjykatat themelore. Sidoqoftë, janë dy raste të veçanta;
 - a. **Në Departamentin Special për lëndët nën juridiksionin e Prokurorisë Speciale, të themeluar nga neni 18 i Ligjit për Gjykata.** Panelet gjykuese për lëndët që janë nën juridiksionin e Departamenteve Speciale duhet të përbëhen ekskluzivisht nga gjyqtarë që janë të caktuar në këto departamente. Devijimi nga ligji në lidhje me këtë duhet të monitorohet dhe gjurmohet në çdo kohë. Shih tabelën f. 3 lidhur me Departamentin Special: *Nuk zbatohet.*
 - b. **Në Departamentin e Krimeve të Rënda,** varësisht nga numri i gjyqtarëve në dispozicion dhe numri i lëndëve në punë, mbetet në autoritetin e kryetarit të gjykatës të vendosë për caktimin e anëtarëve të paneleve që do të punojnë në trupave gjykuese dhe anëtarëve të kolegjeve.
- Kryetari i gjykatës ka tre mundësi të ndryshme për formimin e kolegjeve dhe trupave gjykuese:
1. Dy anëtarët e kolegjeve dhe trupave gjykuese caktohen nga gjyqtarët në DKR. Vetëm në mungesë të gjyqtarëve në DKR, anëtarët e kolegjeve dhe trupave gjykuese merren nga DPP.
 2. Njëri anëtarë i kolegjit apo trupit gjykues caktohet nga DKR, ndërsa anëtari i dytë caktohet nga DPP.
 3. Dy anëtarët e kolegjit apo trupit gjykues caktohen nga DPP. Kjo metodë e caktimit të anëtarëve të paneleve zbatohet vetëm me përjashtime, kur gjykata është në rrethana të caktuara në mungesë të gjyqtarëve.
- Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve në dispozicion për të formuar panelin në departamentin të cilit i takon lënda, caktimi i anëtarëve të paneleve bëhet sipas hapave të më poshtëm:

I. Hapi 1, sistemi SMIL në mënyrë automatike cakton anëtarët e panelit duke caktuar në mënyrë rastësore **një gjyqtar nga departamenti tjetër i identifikuar, siç përshkruhet në tabelën më poshtë** (shih kolonën e fundit të tabelës “Mënyra e caktimit të anëtarëve të panelit kur nuk ka gjyqtarë të mjaftueshëm për të formuar panelin në departamentin të cilit i përket lënda”). Për shembull, për Lëndët e Krimeve të Rënda, nëse ka mungesë të gjyqtarëve në Departamentin e Krimeve të Rënda për të krijuar panelin, SMIL-i do të përzgjedhë gjyqtarë nga Departamenti i Përgjithshëm / divizioni penal. Shih tabelën lidhur me DKR, rastin kur nuk gjyqtarë të mjaftueshëm në departament për të krijuar panelin, *gjyqtarët merren nga Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Penal.*

- II. Nëse sipas hapit të parë nuk është e mundur të formohet paneli, atëherë SMIL-i vazhdon me **Hapin 2**. Në këtë hap, sistemi SMIL në mënyrë automatike krijon **një detyrë për kryetarin e gjykatës që në mënyrë manual të caktojë anëtarin (et) e panelit gjykues**. Këto raste janë shumë të rralla dhe mund të mos ndodhin në praktikë, por sistemi duhet të dizajnohet për t'i adresuar edhe rastet shumë të rralla. Në këto raste, kryetari i gjykatës duhet të përzgjedhë anëtarin e panelit nga lista e gjyqtarëve që janë në dispozicion në gjykatë dhe që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin për Gjykata.

Mënyra e krijimit të paneleve në gjykata themelore dhe degët e tyre, në të gjitha rrethanat, si dhe korniza ligjore e cila duhet të zbatohet.

7.1 Caktimi i anëtarëve të paneleve për Gjykata Themelore

Departamenti	Kolegji / Paneli	Mënyra e Caktimit të dy anëtarëve të kolegjit/ panelit	Mënyra e caktimit të anëtarëve të kolegjit/ panelit <u>në mungesë të gjyqtarëve për të krijuar panelin në departamentin që i përket lënda.</u>
Departamenti Special (DS)	1. Trupi gjykues: Kryetari i trupit gjykues dhe dy anëtarët e trupit gjykues. (lënde të rregullta)	1. Dy anëtarët e trupit gjykues caktohen në mënyrë automatike, anëtarët merren nga DS. 2. Gjyqtari rezervë caktohet në mënyrë manuale prej DS nga Kryetari i trupit gjykues. Caktimi bëhet sipas nevojës dhe në momentin që ka nevojë të aktivizohet gjyqtari rezervë.	Nuk është e aplikueshme
	2. Gjyqtari zëvendësues /rezervë		
	3. Kolegji shqyrtues Kryetari dhe dy anëtarët e kolegjit shqyrtues	Dy anëtarët e kolegjit shqyrtues caktohen në mënyrë automatike, anëtarët merren nga DS.	Nuk është e aplikueshme
	4. Paneli për mundësi hetuese të veçantë. Anëtarët e Panelit të mundësisë hetuese të veçantë	Sistemi kujdeset që kryetar i këtij paneli të jetë gjyqtari i procedurës paraprake Dy anëtarët e panelit caktohen në mënyrë automatike, gjyqtarët merren nga DS,	Nuk është e aplikueshme

Departamenti i Krimeve të Rënda (DKR)	1. Trupi gjykues: Kryetari i trupit gjykues dhe dy anëtarët e trupit gjykues. (lënde të rregullta)	1. Anëtarë e trupit gjykues caktohen në mënyrë automatike, sipas pikës 7,b.	Anëtarët e trupit gjykues caktohen në mënyrë automatike, gjyqtarët merren nga Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal.
	2. Gjyqtari zëvendësues /rezervë	2. Gjyqtari rezervë caktohet në mënyrë manuale prej DKR nga Kryetari i trupit gjykues. Caktimi bëhet sipas nevojë dhe në momentin që ka nevojë të aktivizohet gjyqtari rezervë.	Për Gjykatën Themelore në Prishtinë: <u>së pari</u> gjyqtarët merren nga Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal dhe <u>së dyti</u>, nga Departamenti Special në përputhje me Ligjin e gjykatave (Neni 42, pika 3).
	3. Kolegji shqyrtues Caktimi i dy anëtarëve të kolegjit shqyrtues	Anëtarët e kolegjit shqyrtues caktohen në mënyrë automatike, sipas pikës 7,b.	Anëtarët e kolegjit caktohen në mënyrë automatike duke marrë gjyqtarë nga Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal. DPP.
	4. Paneli për mundësi hetuese të veçantë. Caktimi i anëtarëve të panelit të mundësisë hetuese të veçantë	Dy anëtarët e panelit caktohen në mënyrë automatike, gjyqtarët merren nga DKR,	Anëtarët e panelit caktohen në mënyrë automatike duke marrë gjyqtarë nga Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal. (DPP).
Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal. DPP	1. Kolegji shqyrtues. Caktimi i anëtarëve të kolegjit shqyrtues.	Dy anëtarët e kolegjit shqyrtues caktohen në mënyrë automatike, anëtarët merren nga DPP.	Anëtarët e kolegjit caktohen në mënyrë automatike duke marrë gjyqtarë nga Div. për Kundërvajtje.
	2. Kolegjet te rastet me urdhër ndëshkimor	Dy anëtarët e kolegjit caktohen në mënyrë automatike, anëtarët merren nga DPP.	Anëtarët e kolegjit caktohen në mënyrë automatike duke marrë gjyqtarë nga Div. për Kundërvajtje.
Departamenti Civil (DC)	Gjyqtaret porot Kryetari i trupit gjykues përmes detyrës ad-hoc “Shto anëtarët e trupit gjykues/...” përzgjedh anëtarët e trupit gjykues.	Gjyqtarët porot caktohen në mënyrë manuale nga gjyqtari i lëndës.	

Departamenti për të Mitur (DM)	1.Trupi gjykues: Kryetari i trupit gjykues dhe dy anëtarët e trupit gjykues. (lënde të rregullta)	1.Dy anëtarët e trupit gjykues caktohen në mënyrë automatike, anëtarët merren nga DM.	Anëtarët e trupit gjykues caktohen në mënyrë automatike duke marrë gjyqtarë nga Departamenti i Krimeve të Rënda DKR.
	2.Gjyqtari zëvendësues /rezervë	2.Gjyqtari rezervë caktohet në mënyrë manuale prej DM nga Kryetari i trupit gjykues. Caktimi bëhet sipas nevojë dhe në momentin që ka nevojë të aktivizohet gjyqtari rezervë.	
	3.Kolegji shqyrtues. Caktimi i anëtarëve të kolegjit shqyrtues.	Dy anëtarët e kolegjit shqyrtues caktohen në mënyrë automatike, anëtarët merren nga DM.	Anëtarët e kolegjit caktohen në mënyrë automatike duke marrë gjyqtarë nga Departamenti i Krimeve të Rënda DKR.
4.Paneli me mundësi hetuese të veçantë.	Dy anëtarët e panelit caktohen në mënyrë automatike, anëtarët merren nga DM.	Anëtarët e panelit caktohen në mënyrë automatike duke marrë gjyqtarë nga Departamenti i Krimeve të Rënda DKR.	

7.2 Caktimi i anëtarëve të paneleve për Degët në Gjykata Themelore

Departamenti	Kolegji / Paneli	Mënyra e Caktimit	Mënyra e caktimit të anëtarëve të kolegjit/ panelit <u>në mungesë të gjyqtarëve për të krijuar panelin në departamentin që i përket lënda.</u>
Departamenti Përgjithshëm Penal (DPP)	1.Kolegji shqyrtues. Caktimi i anëtarëve të kolegjit shqyrtues.	Dy anëtarët e kolegjit shqyrtues caktohen në mënyrë automatike, anëtarët merren nga DPP.	Anëtarët e kolegjit caktohen në mënyrë automatike duke marrë gjyqtarë nga lista e të gjithë gjyqtarëve që janë në dispozicion në Degë të Gjykatës Themelore.
	2.Kolegjet tek rastet me urdhër ndëshkimor.	Dy anëtarët e kolegjit caktohen në mënyrë automatike, anëtarët merren nga DPP.	Anëtarët e kolegjit caktohen në mënyrë automatike duke marrë gjyqtarë nga lista e të gjithë gjyqtarëve që janë në dispozicion në Degë të Gjykatës Themelore.
Departamenti Civil (DC)	Gjyqtaret porot vetëm per kontestimore dhe jokontestimore	Gjyqtarët porot caktohen në mënyrë manuale nga gjyqtari i lëndës.	

8. *Caktimi i gjyqtarëve dhe anëtarëve të kolegjeve në Gjykatën Komerciale*

Departamenti	Gjyqtari Kolegji / Paneli	Mënyra e Caktimit të dy anëtarëve të kolegjit/ panelit	Mënyra e caktimit të anëtarëve të kolegjit/ panelit në mungesë të gjyqtarëve për të krijuar panelin në departamentin që i përket lënda.
Gjykata Komerciale Shkalla e Parë – Caktimi i gjyqtarit të lëndës			
Departamenti për Çështje Ekonomike (Lende Ekonomike)	Gjyqtari i lëndës	Gjyqtari caktohet në mënyrë automatike nga departamenti që i përket lënda.	Caktohet detyrë për kryetarin e gjykatës për të caktuar gjyqtarin.
Departamenti për Çështje Ekonomike (Lendet përmbarimore)	Gjyqtari i lëndës	Gjyqtari caktohet në mënyrë automatike nga departamenti që i përket lënda.	Caktohet detyrë për kryetarin e gjykatës për të caktuar gjyqtarin.
Divizioni për Kontestet Lidhur me Investitorët e Huaj	Gjyqtari i lëndës	Gjyqtari caktohet në mënyrë automatike nga departamenti që i përket lënda.	Gjyqtari caktohet nga Departamenti për Çështje Ekonomike
Departamenti i Përgjithshëm	Gjyqtari i lëndës	Gjyqtari caktohet në mënyrë automatike nga departamenti që i përket lënda.	Gjyqtari caktohet nga Departamenti për Çështje Ekonomike
Departamenti Fiskal	Gjyqtari i lëndës	Gjyqtari caktohet në mënyrë automatike nga departamenti që i përket lënda.	Gjyqtari caktohet nga Departamenti për Çështje Administrative.
Departamenti për Çështje Administrative	Gjyqtari i lëndës	Gjyqtari caktohet në mënyrë automatike nga departamenti që i përket lënda.	Gjyqtari caktohet nga Departamenti Fiskal.

Gjykata Komerciale Shkalla e Dytë – Caktimi i kolegjeve		
Shkalla II. Çështje Ekonomike (Lende Ekonomike Kontestet Lidhur me Investitorët e Huaj)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i kolegjit 2. Anëtarë kolegji 3. Gjyqtari zëvendësues /rezervë 	Kryetari i kolegjit, anëtarët e kolegjit dhe gjyqtari rezervë caktohen në mënyrë automatike. Gjyqtarët merren nga gjyqtarët e shkallës së dytë.
Shkalla II. Çështje Ekonomike (Lendet përmbarimore)	Gjyqtari i lëndës (gjyqtarë individual)	Gjyqtari caktohet në mënyrë automatike. Gjyqtarët merren nga gjyqtarët e shkallës së dytë.
Shkalla II. Kërkesë për përsëritje të procedurës	Gjyqtari i lëndës (gjyqtarë individual)	Gjyqtari caktohet në mënyrë automatike. Gjyqtarët merren nga gjyqtarët e shkallës së dytë.
Shkalla II. (Përgjithshme)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i kolegjit 2. Anëtarë kolegji 3. Gjyqtari zëvendësues /rezervë 	Kryetari i kolegjit, anëtarët e kolegjit dhe gjyqtari rezervë caktohen në mënyrë automatike. Gjyqtarët merren nga gjyqtarët e shkallës së dytë.
Shkalla II. (Fiskale)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i kolegjit 2. Anëtarë kolegji 3. Gjyqtari zëvendësues /rezervë 	Kryetari i kolegjit, anëtarët e kolegjit dhe gjyqtari rezervë caktohen në mënyrë automatike. Gjyqtarët merren nga gjyqtarët e shkallës së dytë.
Shkalla II. (Çështje Administrative)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i kolegjit 2. Anëtarë kolegji 3. Gjyqtari zëvendësues /rezervë 	Kryetari i kolegjit, anëtarët e kolegjit dhe gjyqtari rezervë caktohen në mënyrë automatike. Gjyqtarët merren nga gjyqtarët e shkallës së dytë.

Për lëndët që shkojnë për herë të tretë në dhomat e shkallës së dytë, procesi duhet të përmbyllet në SMIL nga dhoma e shkallës së dytë dhe sistemi nuk lejon që lënda të kthehet në rivendosje në shkallë të parë për herë të tretë.

II. SHPËRNDARJA MANUALE

Kjo metodë përdoret për caktimin e gjyqtarëve porot dhe gjyqtarëve për lëndë urgjente (të kujdestarisë). Sistemi shfaqë për përdoruesin listën e gjyqtarëve, dhe nga aty referenti (regjistruesi i lëndës) pastaj përzgjedhë gjyqtarët.

Për të realizuar shpërndarjen manuale të lëndëve në procedurë paraprake, nevojitet që gjykatat të bëjnë plane të rregullta të kujdestarisë. Planet duhet të bëhen për periudha jo më të gjata tre muaj, në të cilën përcaktohen orari i gjyqtarëve që do të jenë në kujdestari. Referentët që merren me regjistrimin e lëndëve, për lëndët e procedurës paraprake caktojnë gjyqtarët sipas planit të përcaktuar paraprakisht nga gjykata.

III. Tabela: Zbatimi i planit të shpërndarjes së lëndëve

I. Gjykatë Themelore		
Gjyqtari	Mënyra e shpërndarjes se lëndëve	
Gjyqtari i procedurës paraprake	Manuale	Referenti, gjatë pranimit të lëndës, duke u bazuar në planin javor/mujor të kujdestarisë, nga lista të cilën e vë në dispozicion sistemi, përzgjedhë gjyqtarin e procedurës paraprake.
Gjyqtari gjykues, Kryetari i trupit gjykues (lëndë të rregullta)	Automatike	Sistemi duhet te kujdeset që njëri nga dy anëtarët e Panelit të Mundësisë hetuese të veçantë (<i>Përjashtohet gjyqtari i procedurës paraprake</i>) të jetë gjyqtarë i vetëm gjykues ose kryetar i trupit gjykues.
Gjyqtari gjykues, Kryetari i trupit gjykues (lëndë urgjente psh. Me kërkesë për caktim/vazhdim të paraburgimit)	Manuale	Referenti, gjatë pranimit të lëndës, duke u bazuar në planin javor/mujor të kujdestarisë, nga lista të cilën e vë në dispozicion sistemi, përzgjedhë gjyqtarin.
Anëtarët e trupit gjykues në gjykatën themelore	Automatike	Sistemi duhet te kujdeset që njëri nga dy anëtarët e Panelit të Mundësisë hetuese të veçantë (<i>Përjashtohet gjyqtari i procedurës paraprake</i>) të jetë anëtar i trupit gjykues.
Kryetari dhe anëtarët e kolegjit shqyrtues	Automatike	
Anëtarët e Panelit të mundësisë hetuese të veçantë	Automatike	Sistemi kujdeset që kryetar i këtij paneli të jetë gjyqtari i procedurës paraprake.
Gjyqtarët porot	Manuale	Kryetari i trupit gjykues përmes detyrës ad-hoc “Shto anëtarët e trupit gjykues/...” përzgjedhë anëtarët e trupit gjykues.

II. Gjykata e Apelit		
Gjyqtari	Mënyra e shpërndarjes së lëndëve	
Kolegji gjykues në (për lëndë urgjente)	Manuale	Sistemi vë në dispozicion listën e gjyqtarëve, pastaj referenti i pranimit, duke u bazuar ne orarin e kujdestarisë të gjykatës, përzgjedhë anëtarët e kolegjit.
Gjyqtari raportues/relator (Lëndë të rregullta)	Automatike	
Kryetari i kolegjit gjykues (Lëndë të rregullta)	Automatike	
Anëtarët e kolegjit gjykues (Lëndë të rregullta)	Automatike	

III. Gjykata e Supreme		
Gjyqtari	Mënyra e shpërndarjes së lëndëve	
Gjyqtari raportues/relator	Automatike	
Kryetari i kolegjit gjykues	Automatike	
Anëtarët e kolegjit gjykues	Automatike	

Këto kritere për shpërndarjen e lëndëve përmes Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL) vlejné dhe janë të zbatueshme në të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.

Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Prishinë

Datë _____